LIGJ
Nr.8340/1, datë 6.5.1998

PËR RREGULLIMIN E PASOJAVE QË KANË RRJEDHUR NGA ZBATIMI I DEKRETIT NR.204, DATË 5.6.1992 "PËR PASURINË E SINDIKATAVE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pasuritë e sindikatave të fituara nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 konsiderohen pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme dhe vlerat monetare të ish-Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, sipas inventarizimit dhe vlerësimit të bërë nga Komisioni i ngritur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë në muajin qershor të vitit 1992, mbi bazën e gjendjes faktike të muajit mars të vitit 1991.

Neni 2

Aktmarrëveshjet e arritura ndërmjet sindikatave, për ndarjen e pasurisë, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë vlerë juridike me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Mosmarrëveshjet që lidhen me këto aktmarrëveshje zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 3

Rishpërndarja e pasurisë së sindikatave, në rastin e shkëputjes së fraksioneve dhe krijimit të sindikatave të reja nga ato ekzistuese, bëhet mbi bazën e marrëveshjes në përpjestim me numrin e anëtarëve të tyre. Në rast mosmarrëveshjesh ato zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 4

Pasuria e paluajtshme e përfituar nga sindikatat në bazë të këtij ligji nuk mund të tjetërsohet deri më 31.12.2020.

Neni 5

Trualli pasuri e sindikatave sipas nenit 1 të këtij ligji, konsiderohet pronë e zënë. Ish-pronarët kompensohen sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Neni 6

Sindikatat, në administrimin e pasurive të tyre duhet të respektojnë objektivin e veprimtarisë sindikaliste.

Kontratat e qiradhënies të lidhura nga sindikatat që nuk respektojnë detyrimin e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni nuk mund të ripërtërihen.

Neni 7

Objektet e kulturës së ish-ndërmarrjeve bujqësore kalojnë në pronësi të organeve të pushtetit

lokal.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë mënyrën e kalimit të pronësisë dhe organet përkatëse të pushtetit lokal, të cilave do t'u kalojnë objektet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 8

Ngarkohet Kontrolli i Lartë i Shtetit, të kontrollojë administrimin e pasurisë së paluajtshme që përfituan sindikatat nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 deri më datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për të propozuar masat përkatëse ligjore.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2090, datë 12.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani